



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 12/17
Prishtinë, më 19.12.2017, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Mytaher Haskuka.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza - Ministër i Financave (tash e tutje Ministri), Salvador Elmazi Gëzim Bislimi dhe Milaim Aliu nga Ministria e Financave.

Pjesëmarrës tjerë: Doruntinë Maloku – deputete, Blerat Deliu – Kodra – deputete, Saranda Bogujevci – deputete, Arbërie Nagavci – deputete, Sali Salihu - deputet, Shkëlqim Xhema dhe Blerim Kabashi – Zyra Kombëtare e Auditimit, Hasan Isufi (MF-GIZ).

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku.

1. Shqyrtimi Raportit me amendamentet për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Kryetari- falënderoj Ministrin me ekipin e tij për mbështetjen në punën tonë. Siç jemi të informuar gjatë javës së kaluar grupet punuese kanë mbajtur takimet dhe dëgjimet buxhetore, kemi shqyrtuar kërkesat buxhetore, ndërsa në një mbledhje të komisionit kemi shqyrtuar amendamentet e deputetëve. Pjesë e raportit janë edhe amendamentet e deputeteve që kemi përkrahur dhe ato nuk janë përkrahur. Amendamentet që kemi votuar në komision vetëm i verifikojmë a janë pasqaruar ato që janë votuar dhe i kalojmë. Ndërkaq, amendamentet që nuk janë votuar, siç është amendamenti i propozuar nga ministria e financave për mbulimin e shpenzimeve të reja që kemi propozuar ne, duhet votuar.

Ministri - Është një moment i ri pozitiv për buxhetin e vitit 2018, bazuar në legjislacionin aktual në fuqi janë të sigurta edhe 11,000.000 milionë euro shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës nga fondi i kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe gjithmonë flas me procedurë ligjore dhe Qeveria e ka marrë shkresën nga bordi Pensional i Fondit të Kosovës që pritet të merret vendime dhe këto mjete të derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës në 3 mujorin e parë të vitit të ardhshëm. Ne këtë çështje e kemi biseduar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar sepse do të ketë refleksione në tabelën 1. të buxhetit dhe do të rritet tavani i shpenzimeve buxhetit të investimet kapitale edhe për 11,000.000 milionë euro dhe përveç kësaj deficiti primar do të jetë brenda rregullës fiskale dhe efekti për bilancin bankar do të jetë neutral sepse ne kemi rritur të pjesa e shpenzimeve si rezultat i akomodimit të amendamenteve të reja. Prandaj ju kisha lutur që në këtë situatë të re që ne i kemi propozuar si amendament ta marrim në konsideratë dhe pastaj kjo do të reflektohet në tabelën 1, tabelën 3.1 dhe tabelën 3.2.

Një çështje që besoj që nuk e ndërron çështjen e buxhetit dhe ne kështu do ta akomodojmë është çështja e mjeteve në mallra dhe shërbime i cili është kërkuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve në shumë prej 600,000 euro dhe unë si Ministër i Financave e lus Komisionin për Buxhet dhe Financa që ta merr në konsideratë. Një çështje tjetër propozojmë që tek Zyra e Kryeministrit të pjesa e komuniteteve të ngritet edhe një shumë prej 500,000 euro.

Naser Osmani - Kjo që ka të bëjë me mjetet e Fondit Pensional është e rregulluar me ligj edhe për ta bërë ndryshimin është fjala të mjetet të cila nuk ka adresë të cila me vitet e tëra janë të qarkullu dhe të pa adrese. Propozimi tjetër për ndarjen e mjeteve tek Zyra e Kryeministrit për zgjidhjen e komuniteteve nuk ishte dashur mu ngut sepse ata kanë mjete në dispozicion të cilat edhe ashtu nuk janë mjete të specifikuara dhe unë konsideroj që këtë 500,000 mijë euro do të ishte më mirë që shpërnda në kërkesa të tjera sepse konsideroj që ky komunitet ka mjaftueshëm para në dispozicion.

Dardan Molliqaj - Unë kam veç pyetje sa i përket kësaj të dytës që i ngriti z. Osmani a dihet për çka është kjo kërkesë shtesë apo vetëm një shumë e caktuar dhe nëse ka arsye mund ta mbështesim?

Ministri - nuk po flasim për një komunitet po flasim për të gjitha komunitetet dhe Zyra e Kryeministrit ka bërë kërkesë që të ketë ma shumë fonde shtesë brenda këtij programi me qëllim për ti përkrah komunitetet.

Ali Lajçi - Mbasi kemi tashti amendamente të reja edhe kemi disa përfaqësues që janë këtu të pranishëm propozoj që këto të trajtohen në mënyrë të veçantë, veç e veç dhe njëkohësisht ti arsyetojnë këtu vetë ata që e kanë shkruar amendamentin dhe të jenë në pajtueshmëri me rregullat procedurale të cilat janë të rezervuara.

Blerim Kuqi – theksoi se amendamentet e deputetëve të cilat në aspektin teknik nuk i kanë përgatitur ashtu mirë ose nuk u aprovuar komplet shuma, ato do të shkojnë në emër të komisionit po kërkesa e tyre është a ka mundësi me qenë emri i tyre si nismëtar të këtyre amendamenteve sepse punën më të madhe ata kanë bërë dhe ne i kemi përkrahur.

Safete Hadërgjonaj – çështja e këtyre amendamenteve të hartuar jo mirë teknikisht ka qenë një pjesë pak e ndishme sepse shumica e deputetëve nuk kanë pranuar mi tërheq amendamentet e

tyre. Ne këtë çështje duhet ta analizojmë pak me seriozitet gjatë fillim vitit të ardhshëm në mënyrë që të gjitha ato amendamente të cilat nuk janë të formuluar mirë dhe siç e kërkojnë rregullat procedurale për të qenë pjesë e buxhetit mos të jenë të përfshira në raport dhe mos të jenë në objekt të shqyrtimit nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, por nëse komisioni e sheh të arsyeshme dhe të domosdoshme që mjetet e tilla të ndahen sepse janë të nevojshme për interesat e qytetarëve, ato të përkrahen. Zgjidhja që është propozuar përmes paraqitjes së një tablele përmbledhëse me të gjitha amendamentet e propozuara është e mirë dhe secili amendament i cili është përkrahur nga komisioni është i evidentuar në faqen e 1 dhe ata mund të dalin para qytetarëve që iu kanë aprovuar amendamentin e tyre. Prandaj është mirë që amendamentet e tilla si dy propozime mos të figurojnë në raport dhe të mbesin vetëm amendamentet e komisionit, që mos të shkaktohet konfuzitet me rastin e votimit në Kuvend.

Ministri - çdo gjë që shtohet më tepër deputeti që e ka propozuar amendamentin duhet me tregu edhe burimin e financimit dhe ka pasur raste kur deputetët e kanë propozuar amendamentin i kanë propozuar shtesat dhe ndërsa s'kanë treguar ku mirren mjetet dhe si rezultat është amendament i pa plotë dhe çështja është edhe më e rëndë në disa raste ku kanë propozuar disa herë me i shkurtu projektet të cilat veç kanë kontratë. Ministria e Financave ka ardhur me propozime ku i siguron mjetet është në autoritetin e komisionit se çfarë vendimi merr.

Dardan Molliqaj – sa i përket kërkesës për ndarjeve e mjeteve buxhetore për komunitete, unë e lexova përshkrimin shqip dunë për veti e mbështes për shkak se e pash që ka të bëjë me integrim të minoriteteve. Po ashtu është kërkuar ndërhyrje në renovim të shkollave dhe 100.000 mijë euro ishin paraparë për raste sociale të cilat ishin krejt në rregull dhe nëse është i qëndrueshëm ky shpjegim që ka ardhur unë e mbështes.

Kryetari - Po i hedh në votim 3 propozimet e Ministrisë për ndryshimet e buxhetit. Në bazë të propozimeve të Ministrisë së Financave dhe pas diskutimeve, kryetari konstatoi Komisioni nxori këtë

Përfundim

1. Me 8 vota për, 2 abstenime dhe 1 kundër, miratoi propozimin që në Tabelën 1, Tabelën 3.1, dhe Tabelën 3.2 të Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018, të ngritet tavan i shpenzimeve kapitale në shumë prej 11 milion Euro. Ngritja e tavanit financohet plotësisht nga pranimi i fondeve të pa-alokuara të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Me 8 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, miratohet propozimi që në Organizatën Buxhetore “Akademia e Shkencës dhe Arteve të Kosovës”, në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime, të rritet buxheti për 60,000 euro.
3. Me 9 vota për, 1 kundër dhe asnjë abstenim, miratohet propozimi që organizatën buxhetore “Zyra e Kryeministrit”, tek nënprogrami Zyra për Komunitete”, me kod 15600, në kategorinë e shpenzimeve “subvencionet dhe transferet” të shtohet shuma prej 500,000 euro.

Kryetari - Po i kthehem dokumentit bazë edhe një herë amendamentet që janë votuar nuk hidhen në votim vetëm i shikojmë a ka ndonjë pajtueshmëri me atë që e kemi votuar dhe kur vijim te amendamentet e deputetëve vetëm deputetë që kanë propozuar amendament kanë të drejtë të marrin fjalë dhe mund të japin arsyetimin përkatës.

Kryetari - amendamentet 1,2,3,4,5 janë votuar, unë i shikova dhe janë rregull a ka ndokush komente për to.

Lulzim Rafuna - Vetëm ta rregullojmë pak teknikisht Ministri tek amendamenti i 4, Ministri i Financave mund të bëjë ndarjen e mjeteve të parapara fjala “në Ministrinë e Financave” duhet të zëvendësohet me fjalën ‘nga Ministria e Financave’.

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri miratoi propozimin që në amendamentin 4, në rreshtin e parë fjala nga fjala “në Ministrinë e Financave” zëvendësohet me fjalën ‘nga Ministria e Financave’. Amendamenti 6 ka të bëjë me mjetet që ka propozuara Ministria e Financave për kursimet e brendshme për të mbuluar ndryshimet shtesë që kemi propozuar me amendamentet e propozuara.

Ministri - Te pjesa e ndarjeve që kemi propozuar në amendamentin 6 duhet me u ndryshue, që këto 11,000.000 milionë euro nga fondet pensionale, dhe tash zvogëlohen shkurtime për 11,000.000 milionë euro dhe kthehen mjetet si 1,000.000 milionë euro te autostrada e Gjilanit.

Kryetari – pyeti ministrin sa është vlera e shkurtimeve të propozuara në total?

Ministri - Vlera e shkurtimeve të propozuara ekzakt është 19,709.991 milionë euro dhe kjo vlerë zvogëlohet për 11,000.000 euro nga fondet pensionale dhe tashti shkurtime mbesin 8,709.991 euro.

Kryetari – konstatoi se Komisioni me 8 vota, 2 abstenime dhe asnjë kundër, miratoi amendamentin 6, që janë propozimet e Ministrisë së Financave (përfshirë ndryshimet e bëra sot në këtë amendament) për shkurtime e brendshme buxhetore për të mbuluar ndarjet e propozuara nga komisioni.

Kryetari – a ka dikush me shtu diçka për amendamentin e 7?.

Dardan Molliqaj - Mua po më duket që jemi vonë por këtu te pika 1.6 stafi mbështesë politik i Kuvendit. E kam parë që Kryesia e Kuvendit e ka marrë një vendim për punësimin e këshilltarëve, dhe po më duket keni bërë gabim që i keni hequr këshilltarët politikë sepse nëse e sheh stafin e Kryetarit të Kuvendit i ka 14 anëtar. Në anën tjetër nëse e sheh stafin e Ministrave dhe zv.ministrave prapë kanë staf shumë, ndërsa kryetarët e komisioneve dhe Grupe Parlamentare shumë pak. Nuk e di a ka hapësirë ligjore, por mendojë dhe është mirë që komisioni me plotësue dhe me shtu nga një këshilltar politik për kryetarët e komisioneve.

Kryetari - Fjala ishte për 14 këshilltar për grupet parlamentare dhe pasi kemi kalkuluar se paga e një këshilltari është 2,000 euro sipas planifikimit financiar ne i kemi kthyer në asistent për një

pagë 700 euro dhe brenda këtyre njerëzve këta mund të shpërndahen te komisionet. Ne nuk kemi kompetencë me shtu staf për komisionet pa bë një kërkesë e tillë.

Dardan Molliqaj - E para mendoj që nuk është e drejtë këshilltarët që tashti po shkojnë paguhen më lirë sesa këshilltarë tjerë. Kryetari i Kuvendit ose këshilltari i nënkryetarit të Kuvendit paguhen me një shumë me të njëjtin status. Nuk po themë që duhet me ja rritur rrogat por duhet me pasur një trajtim të barabartë. Ndoshta tashti nuk kemi më kohë por seriozisht duhet me pas këshilltar shtesë për kryetarë të komisioneve dhe nuk është barrë e madhe.

Kryetari - konstatoi se amendamenti 7 kalon pa ndryshime.

Kryetari - Amendamenti 8,9 nuk ka asnjë koment. Tek amendamenti 10 sa për informim i kemi shtuar 900,000 mijë euro për eliminimin e problemeve për qentë endacak në gjithë Kosovën. Amendamenti 11,12,13 nuk ka koment. Amendamenti 14 këtu kemi një kërkesë prej Ministrisë duhet me u votu pika 1.1. ku në Departamenti i Infrastrukturës Rrugore me kod (205-41500) në kategorinë e shpenzimeve kapitale ne tabelën 3.2 , projekti me kod 15723 ‘Furnizimi me vetura për NJP Arabe’ shumë prej 50,000 € te ndryshohet burimi i financimit nga grantet qeveritare - 10 në burimin e financimit financimi nga huamarrja-04. Kryetari konstatoi se miratohet pika 1.1. e amendamentit 14. Amendamenti 15 nuk ka komente.

Fikrim Damka – pasi që amendamentin 82 është përkrahur nga komisioni projektet Qendrën Rinore në Mamushë, e tërheq këtë amendament dhe propozojë që ky projekt të jetë pjesë amendamentet 16 të komisionit.

Kryetari – konstatoi se komisionit miratoi amendamentin 16, me një pikë shtesë 1.7. ku nën-programin “Zhvillimi dhe Përkrahja e Rinisë”, në tabelën 3.2., me kod 80700, në Projektin me kod 15621 “Qendra Rinore në Mamushë”, shuma prej 150,000 euro e paraparë në vitin 2020, bartet në vitin 2018. Ndërsa, hiqet amendamenti 82 i GP 6 + lidhur me këtë projekt.

Kryetari-Amendamenti 17,18 nuk ka komente. Amendamenti 19 ka dy propozime:Komisioni Funkcional dhe deputeti Enver Hoti.

Enver Hoti – në amendamentin 19, më duket se është bërë një gabim z.Ministër sepse atë ditë me propozimin e juaj ishte që 150,000 mijë euro të jipen për vitin 2018 dhe ndërsa për vitin 2019 të ndahen 400.000 mijë euro. Ndërsa këtu në amendament janë rekomandimet përsëriten 2 vitet buxhetore vetëm nga 150,000 euro. Ndërsa unë amendamentin tim pajtohem me tërheq dhe vetëm këtë përmirësim nëse mundet mu rregullu.

Ministri - Po flasim për 450,000 euro për vitin 2019 del ajo shumë që është duke e thënë deputeti,dhe kjo reflekton te burimet e financimit.

Kryetari – konstatoi se komisioni njëzëri miratoi ndryshimin në amendamentin 19 të komisionit funksional, në pikën 1.1. për Projektin “Ndërtimi i qendrës për banim social në Malishevë” për vitin 2019 shuma 150,000 euro ndryshohet në shumën 450,000 euro. Amendamenti i deputetit Enver Hoti tërhiqet me kërkesën e tij.

Kryetari - Amendamenti 20 nuk ka koment. Amendamenti 21 ka 2 propozime: njëri i Komisionit e tjetri i deputetes Doruntina Malokut.

Doruntina Maloku - Amendamenti im është përkrahur nga komision funksional por jo në plotësi sepse projektet në realizmin e shkollës në fshatin Bajqinë është për vitet 2017-2019, ndërsa ju si komisioni i keni alokuar këto mjete e munguara d.m.th 200,000 euro për vitin 2020.

Ministri - Po deputetja ka të drejtë mjetet të cilat kanë pasur me kaluar në vitin 2020 kalojnë në vitin 2019, po ndërrojnë tabelat ndërrojnë edhe burimet e financimit.

Kryetari – konstatoi se komisioni njëzëri miratoi amendamentin e propozuar nga deputetja Doruntinë Maloku, me tekstin si në vijim: “Në Organizatën Buxhetore “Ministria e Administratës Publike”, me kod organizativ 202, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programin “Departamenti i Standardeve dhe Politikave IMNQ”, me kod 12300, në tabelën 3.2., në projektin me kod 14031 “Ndërtimi i shkollës fillore në Bajqinë Podujevë,” në vitin 2019, shuma prej 300,000 euro, ndryshohet në shumën 889,566 euro, në vitin 2020 shuma prej 390,000 euro bëhet 0 (zero). Amendamenti i deputetes Doruntinë Maloku, tërhiqet me kërkesën e saj.

Kryetari - për amendamentet 22,23,24,25 nuk ka komente. Amendamenti 27,28,29,30 nuk ka koment. Amendamenti 31 ka dy propozime: i komisionit dhe deputetes Mirjeta Kalludra.

Naser Osmani - theksoi se ka biseduar me deputeten Mirjeta Kalludra dhe ka thënë që i tërheq amendamentet.

Kryetari -Tërhiqet amendamenti i deputetes Mirjeta Kalludra dhe mbetet vetëm ai i komisionit.

Kryetari - Amendamenti 32 i ka dy propozime: i komisionit dhe i deputetit Ahmet Isufi.

Blerim Kuqi – me autorizimin e deputetit Ahmet Isufi, tërhiqet amendamenti i tij dhe të mbetet vetëm propozimi i Komisionit.

Kryetari – Tërhiqet amendamenti i deputetit Ahmet Isufi dhe mbetet vetëm ai i komisionit. Amendamenti 33 dhe 34 i kemi dy propozime: i komisionit dhe i deputetit Mërgim Lushtaku.

Mërgim Lushtaku - deklarojë se tërheq dy amendamentet të propozuara nga ai dhe të mbesin propozimet e komisionit.

Kryetari – Tërhiqen dy amendamentet e deputetit Mërgim Lushtaku dhe mbesin amendamentet e komisionit. Amendamenti 35 dy propozime, i komisionit dhe i deputetes Mirjeta Kalludra.

Naser Osmani - theksoi se ka marrë autorizimin nga deputetja Kalludra për të tërhequr amendamentin dhe të mbetet propozimi i komisionit.

Kryetari - Tërhiqet amendamenti i deputetes Mirjeta Kalludra dhe mbetet vetëm ai i komisionit. Amendamenti 36 dy propozime: propozimi i komisionit dhe i deputetes Time Kadriaj.

Blerim Kuqi - me autorizim të deputetes Kadriaj, tërheq amendamentin e saj që është përkrahur nga komisioni.

Kryetari - Tërhiqet amendamenti i deputetes Time Kadriaj dhe mbetet vetëm amendamenti i komisionit. Amendamenti 37 dy propozime: i komisionit dhe i deputetëve Hajdar Beqa dhe Teuta Haxhiu.

Blerim Kuqi - sa i përket deputetes Teuta Haxhiu ajo ka deklaruar se tërheq amendamentin.

Kryetari – Tërhiqet amendamenti i propozuar nga deputetët Hajdar Beqa dhe Teuta Haxhiu dhe mbetet amendamenti i komisionit. Amendamenti 38 dy propozime: i komisionit dhe i deputetit Nezir Çoçaj dhe i komisionit.

Safete Hadërgjonaj - unë kam biseduar me Nezir Çoçaj dhe ka pranë mi tërheq amendamentin që ju ka përkrahur.

Kryetari – Tërhiqet amendamenti i deputetit Nezir Çoçaj dhe mbetet vetëm amendamenti i komisionit. Amendamenti 39 dy propozime, i komisionit dhe deputetit Nait Hasani. Meqenëse nuk kemi konfirmim prej deputetit po e lëmë kështu me dy propozime dhe ai mundet me tërheq në seancë.

Kryetari - Amendamenti 40 dy propozime: i komisionit dhe deputetit Islam Pacolli. Meqenëse nuk kemi konfirmim prej deputetit po e lëmë kështu me dy propozime dhe ai mundet me tërheq në seancë.

Kryetari - Amendamenti 41 dy propozime: i komisionit funksional dhe i deputetit Enver Hoti.

Enver Hoti – e tërheq amendamentin tim dhe të mbetet i komisionit funksional.

Kryetari - Amendamenti 42 dy propozime: i komisionit funksional dhe deputetit Enver Hoti.

Enver Hoti – e tërheq amendamentin tim dhe të mbetet i komisionit funksional.

Kryetari - Amendamenti 43 komisioni funksional dhe deputeteve Hajdar Beqa dhe Teuta Haxhiu. Në bazë të autorizimit të tyre tërhiqet amendamenti i deputetëve dhe mbetet ai i komisionit.

Kryetari - Amendamenti 44 dy propozime: i komisionit dhe i deputetit Daut Haradinaj.

Blerim Kuqi – me autorizimin e deputeti Daut Haradinaj, tërhiqet amendamenti i tij dhe të mbetet propozimi i komisionit.

Kryetari - konstatoi se tërhiqet amendamenti i deputetit Daut Haradinaj dhe mbetet i komisionit. Amendamenti 45 dy propozime: i komisionit funksional dhe i deputetes Evgjëni Thaqi-Drăgusha. Deputetja në ndërkohë ka tërhequr amendamentin dhe mbetet ai i komisionit.

Kryetari - Amendamenti 46 nuk ka koment. Amendamenti 47 dy propozime: i komisionit dhe i deputetit Bekim Haxhiu.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se ka biseduar me deputetin Bekim Haxhiu dhe ka deklaruar se i tërheq të katër amendamentet e tij që kanë përkrahjen e komisionit dhe mbesin propozimet e komisionit funksional..

Kryetari - Amendamenti 48, dy propozime: i komisionit funksional dhe i deputetes Saranda Bogujevci.

Saranda Bogujevci – Amendamenti im ka të bëjë me peticionin që ka ardhur nga banorët e Orllanit për ujësjellësin për problemin me ujë të pijshëm që kanë. Banorët e kanë ditur këtë çështje prej vitit 2011 është praktikisht edhe rekomandimi i komisionit në vitin 2012 që ka shkuar për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor por edhe për Kuvendin Komunal të Podujevës. Ujësijellësi Rajonal i Prishtinës ka bërë projektin ideor edhe është paraparë shuma që totali për me realizue projektin është 1,340.000 mijë euro por propozime ka qenë që për vitin 2018 me fillue me 500,000 mijë euro dhe pastaj me vazhdue në vitin 2019 me përfunduar projektin.

Ministri - Në këtë rast unë mendoj që për vitin 2018 mos me ndryshu shuma pasi që nuk mundën me ekzekutuar ma shumë punime se ende nuk janë duke u zhvilluar procedurat por ne për vitin 2019 dhe sidomos në vitin 2020 të rritet shuma edhe të plotësohet konkret kërkesa për këtë projekt.

Kryetari – konstatoi se Komisioni miratoi ndryshimin e amendamentit 48, me tekstin si në vijim: “Në Organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, bëhen ndryshimet si në vijim: Nën-programi “Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, me kod 60800, shtohet projekti i ri “Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatin Orllan, Podujevë”, në shumë prej 200,000 euro për vitin 2018. Në vitin 2019 shtohen shuma 400,000 euro dhe në vitin 2020 shtohet shuma 740,320 euro”. Amendamenti i deputetes Saranda Bogujevci, tërhiqet me kërkesën e saj.

Kryetari - Amendamenti 49, dy propozime: i komisionit funksional dhe deputetit Enver Hoti.

Enver Hoti - z.Ministër edhe këtu na ka përsëritur një gabim, pasi që projekti ka qenë e ndarë në dy faza 2018-2019. Për vitin 2019, të shtohen edhe 300,000 euro.

Kryetari – konstatoi se në projektin e ri “Projekti Kanalizimi në fshatrat Lladrovç-Carrallukë-Malishevë”, në vitin 2019 shtohen shuma prej 300,000 euro dhe kalon amendament i komisionit, ndërsa deputeti Enver Hoti tërheq amendamentin me kërkesën e tij.

Kryetari - Amendamenti 50,51,52,53 nuk ka komente. Amendamenti 54 dy propozime: i komisionit funksional dhe i deputetit Rasim Selmanaj.

Blerim Kuqi - Amendamenti i deputetit Rasim Selmanaj me autorizimin e tij tërhiqet.

Kryetari – amendamenti i deputetit Rasim Selmanaj tërhiqet me kërkesën e tij dhe mbetet amendamenti i komisionit. Amendamenti 55 dy propozime: i komisionit dhe i deputetit Enver Hoti.

Enver Hoti - z.Ministër ne e dimë që kemi kësi projekte që kanë mbetur në gjysmë për vite të tëra dhe mendoj që më mirë është me ju shtu ajo pjesa që jemi marrur vesh për 2-vjeçar 2018-2019.

Ministri - po shihet që për këtë vit janë financuar 200,000 mijë euro për vitin 2018 dhe pjesa tjetër prej 300,000 euro të shtohet në vitin 2019.

Kryetari – konstatoi se komisionit miratoi propozimin, që në projektin e ri “Salla e Sportit Drenoc, Malishevë”, në vitin 2019 shtohet shuma prej 300,000 euro. Deputeti Enver Hoti e tërheq amendamentin me kërkesën e tij dhe mbetet ai i komisionit

Kryetari - Amendamenti 56,57,58 nuk ka koment.

Kryetari – në vazhdim i kemi amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, deputeti Armend Zemaj, deputetët Vjosa Osmani, Doruntinë Maloku, Armend Zemaj dhe Arben Gashi, deputetja Besa Gaxherri, deputetja Time Kadriaj, deputetja Mimoza Kusari Lila, deputetja Mirjeta Kalludra, deputeti Rasim Selmanaj, deputeti Lutfi Zharku, Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Nezir Çoçaj, deputeti Enver Hoti, deputeti Hajdar Beqa, Grupi Parlamentar 6+, Blerta Deliu, Arbërie Nagavci, të cilat janë pa përkrahjen e komisionit funksional.

Arbërie Nagavci - Unë i kam parashtruar 2 amendamente. Amendamenti 1 ka të bëjë me implementimin e kontratës kolektive për arsim e cila është nënshkruar me 18 Prill të këtij viti. Pikërisht neni 35 pika 5 e kontratës ka të bëjë me pagat jubilarë dhe 3 pagat përcjellëse vlerat e përgjithshme sipas llogaritjeve është 909,000 euro. Ndërsa amendamenti tjetër ka pasur të bëjë me obligimet ligjore që dalin me ligjin për arsimin paraprak, para universitar dhe me dispozita të tjera të cilat adresojnë edhe çështjet e fëmijëve me nevoja të veçanta ku kam kërkuar planifikimin e buxhetit për pagat për 100 pedagogë dhe psikologë dhe një sistem për fëmijët e veçantë.

Ministri - Gjithçka që është obligim ligjor nga ministritë e linjës është dashur dhe po besojë se i kanë përfshirë në buxhetin e tyre. Ndërsa sa i përket çështjes së numrit të punëtorëve, ata duhet me pas planin e vetë se për cilat shkolla, sa vetë mbi bazën e çfarë kushteve dhe krejt këto janë çështje që duhet me u rregullue brenda ministrisë së arsimit. Prandaj znj. deputete ju lus që shkresën t’ia dërgoni ministrisë së linjës që është e arsimit dhe në proceset e ardhshme buxhetore të rishikimit të vjen prej kësaj ministria kërkesa, përndryshe ne nuk e dimë as cilin kod, ku me i vendosë në buxhet. Nuk po themi që është e pa arsyeshme por jo vetëm për një ministri por për të gjitha ministritë e linjës janë të obliguar që fillimisht brenda buxhetit të tyre ti kryejnë obligimet e tyre ligjore e kontraktore dhe pastaj vendosim projektet.

Kryetari - konstatoi se 2 amendamentet e propozuara nga deputetja Arbërie Nagavci nuk mund të përkrahen për arsye se këto çështje duhet trajtuar dhe rregulluar nga ministritë e linjës.

Blerta Deliu - Në fakt është një kërkesë që e kam dërguar në konsultim me Ministrinë e Kulturës, dhe ata kanë thënë që janë në finalizim të rregullores për qeshjen e kompensimit të aktorëve, performueseve dhe atyre të trashëgimisë dhe pritet me dal në Qeveri në muajin Janar për miratim, që rregullon çështjen e kompensimit të këtyre artistëve.

Ministri – ministri nuk e ka asnjë të drejtë pasi që e ka votuar buxhetin në qeveri. Iu janë plotësuar kërkesat brenda mundësive reale dhe unë jam i bindur që Ministri duhet ta rregullojë dhe ta trajtojë këtë çështje brenda legjislacionit dhe rregulloreve të brendshme të ministrisë. Prandaj sa i përket fondeve ata nuk do të kenë problem dhe nëse ka nevojë për fonde shtesë në çdo kohë Ministria e Financave merr për obligimin që në procedurë të rregullt ligjore me iu mbulu fondet e nevojshme, siç është mundësia prej rezervës së qeverisë.

Kryetari - konstatoi se komisioni nuk përkrahu amendamentin e deputetes Blerta Deliu-Kodra, dhe kjo çështje duhet rregulluar brenda buxhetit të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Kryetari – amendamenti i deputetit Rexhep Selimi nuk është shqyrtuar, pasi që është dërguar pasi që kemi shqyrtuar amendamentet tjera. Janë 180,000 mijë euro për Projektin e ri “ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse (Hapja e shtigjeve dhe lapidarët përkujtimorë), në fshatin Gorozhub në rajonin e Hasit të Komunës së Prizrenit

Ministri – mbështesim amendamentin e deputetit Rexhep Selimi.

Kryetari – konstatoi se komisioni përkrahu amendamentin e deputetit Rexhep Selimi, me tekstin si në vijim: “Në tabelën 3.2, Projektet Kapitale për Nivelin Qendror, kodit 253000 – Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, të shtohet Projekti me emrin: “ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse (Hapja e shtigjeve dhe lapidarët përkujtimorë), në fshatin Gorozhub në rajonin e Hasit të Komunës së Prizrenit, ku me 14 Dhjetor 1998 ranë dëshmor Komandanti Mujë Krasniqi dhe 40 dëshmorët e tjerë të UÇK-së. Për ndërtimin e këtij projekti të ndahen 180,000.00 euro në buxhetin për vitin 2018.”

Kryetari - në vazhdim kemi amendamentin e pa shqyrtuar të deputetit Sali Salihu që në tabelën 3.2., Projektet Kapitale për Nivelin Qendror, të shtohet Projekti me emër “ndërtimi i kyçjes për Vitinë (hyrje dhe dalje) në Autostradën Prishtinë-Shkup në fshatin Gërllicë, të ndahen 500,000.00 euro në buxhetin për vitin 2018.

Ministri - Kjo është çështje brenda kontratës ekzistuese të projektit Prishtinë-Shkup. Kot ne i qesim këto para, pa e marrur lejen dhe pa i krye procedurat dhe ne nuk mundemi me bo projekt të ri me ndonjë kompani të re sepse ai nuk ta lejon kyçen. Prandaj duhet me bisedue Ministrinë e Infrastrukturës dhe me ekzekutuesin e projektit edhe me u bë kyçja.

Salih Salihu - Kontrata ekziston dhe brenda kontratës është edhe shuma dhe kjo është punë shtesë dhe mbasi është punë shtesë kërkon buxhet shtesë dhe unë konsideroj që është mirë të ndahen në buxhet. Janë 11,000.000 euro nga Fondi i Kursimeve Pensionale dhe Vitia është Komunë e izoluar.

Kryetari – konstatoi se Komisionit nuk përkrahu amendamentin e deputetit Salih Salihu, pasi që, çështja e financimit të projektit të kyçje së Vitisë, në autostradën Prishtinë-Shkup, duhet trajtuar dhe zgjidhur nga Ministria e Infrastrukturës.

Kryetari – Amendamenti i Grupit Parlamentar Lista Serbe është në vazhdim.

Ministri – komisioni më herët miratoi propozimin për rritjen e fondit për komunitetet për 500,000 euro.

Kryetari – konstatoi se komisioni nuk e përkrahu amendamentin e Grupit Parlamentar Lista Serbe. Në vazhdim kemi amendamentin e Grupit të deputetëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, ku për Këshillim Konsultativ për Komunitete në Zyrën e Presidentit është kërkuar t'i ndahet fondi shtesë në vlerë prej 46,000.00 €, prej të cilave 6,000.00 € për kategorinë ekonomike Paga dhe kompensime për personelin e Sekretariatit të Këshillit dhe 40,000.00 € për kategorinë ekonomike Mallrat dhe Shërbimet. Fondi shtesë propozohet që të transferohet nga kodi 211 Ministria për Komunitete dhe Kthim, ose nga kodi 104 Zyra për Çështje të Komuniteteve – Zyra e Kryeministrit.

Ministri – nuk e mbështesim amendamentin.

Kryetari – konstatoi se komisioni njëzëri nuk e përkrahu amendamentin e propozuar nga Grupit i deputetëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Kryetari - Amendamenti tjetër është propozuar nga deputeti Liburn Aliu ku është kërkuar që në tabelën 3.2 Projektet Kapitale për Nivelin Qendror, Kodi 210134 - Shpronësim, të shtohet shuma nga 18,400,000,00 euro, në 23.400.000,00 euro, për shpronësimin e pronave private për realizimin e projektit – Unaza e brendshme, Pjesa perëndimore, Segmenti 1, deri te Pallati i drejtësisë, ne Prishtinë. Për fillimin e realizimit të këtij projekti, të ndahen 5.000.000.00 euro, në buxhetin për vitin 2018.

Ministri - Këtu po kërkohet për shpronësimin dhe brenda fondit për shpronësim nuk janë të ndara mjetet për cilindo projekt, por është vetëm si shumë totale edhe përdoret për shpronësim që ndodhin dhe brenda projektit ekzistues. Sinqerisht Ministria e Financave e përkrah financimin e projektit të Unazës në Prishtinë dhe është projekt i madh jo vetëm shpronësimi por edhe financimin e ekzekutimit të këtij projektit, por kur të përgatitet dhe sa i përket procedurave të shpronësimit deri sa të fillojnë edhe deri sa të merren vendimet preliminare, faza e ankesave, vendimi përfundimtar merr kohë por brenda këtij fondit të shpronësimit këto mund të trajtohen.

Kryetari – konstatoi se komisioni njëzëri nuk e përkrahu amendamentin e propozuar nga deputeti Liburn Aliu.

Naser Osmani - Kërkoj falje por Komuna e Gjilanit nuk ka arritur me kohë me dorëzue kërkesën dhe është fjala për projektin 'Flakën e Janarit' të ndahen 53,000 euro.

Ministri – mjetet i ndajmë në mbledhjen e Qeverisë përmes Rezervës së Qeverisë me vendim të Qeverisë, pasi që proceduralisht është më e lehtë për Komunën e Gjilanit ti marrë mjetet se sa të shkojnë në ministri kërkon procedura më të gjata.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se është bërë një gabim teknik pika 1.20 e amendamentit 14, tek Projekti i ri “Asfaltimi i rrugës Strellc-Dranovc, Deçan”, për vitin 2018 është shënuar shuma 100,000 euro. Në fakt 100,000 euro janë në buxhet për këtë projekt, dhe duhet të ndryshojë shuma në 200,000 euro dhe amendamenti i deputetes Time Kadriaj për këtë projekt duhet të tërhiqet.

Kryetrari – konstatoi se Komisioni miratoi propozimin që në amendamentin 14, në pikën 1.20, në projektin e ri “Asfaltimi i rrugës Strellc-Dranovc, Deçan”, për vitin shuma 100,000 euro ndryshohet në 200,000 euro.

Në fund kryetari konstatoi se komisioni njëzëri miratoi raportin me rekomandime për Projektligjin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe i njëjti do të procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

Mbledhja përfundoi në ora 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lumir Abdixhiku